

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 20 MARS 2003**

**T R A N S K R I P T**  
**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 20. 03. 2003. GOD.**

---

**MARS – MART**  
**2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar /Seancat me 6 dhe 13 mars 2003/,
3. Debati lidhur me Ekspozeun e Kryeministrit për punën njëvjeqare të Qeverisë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Farërat (2003/1),
5. Shqyrtimi i Propozimit për miratimin e Iniciativës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemura Park Nacional ,
6. Propozimi i Rendit të ditës për Seancën plenare me 27 Mars 2003,
7. Parashtimi i pyetjeve

---

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.  
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице / 6 и 13 Марта 2003/,
3. Расправа у вези Експозеа Премијера о једногодишњем раду Владе Косова
4. Друго разматрање Нацрта закона о Семену /2003/1/,



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

5. Разматрање предлога о усвајању иницијативе о проглашењу  
Проклетиа за Национални Парк,
6. предлога дневног реда за пленарну седницу дана 27 марта 2003,
7. Постављање питања

---

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор”  
(Правило 21.2 са Привремени пословник)

**AGENDA**

1. Agenda agreed,
2. Minutes of previous meeting / 6 end 13 march 2003/,
3. Debate of the Statement by the Premier for one year work of Government of Kosovo,
4. Second reading of Draft Low on on Seeds (2003/1),
5. Review of the proposal for approval of the initiative to declare the “Bjeshkwt e Nemuna” National Park.
6. Proposal for agenda of the Plenary Session for March, 27 2003,
7. Questions

---

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

# **T R A N S K R I P T**

## **NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20 MARS 2003**

**Seanca filloi punën në orën 10,00.**

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,  
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, SABRI HAMITI, ANËTAR I  
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes kolegë deputetë. Mirë se keni ardhur në seancën e rregullt plenare të Kuvendit.

Meqë numri i deputetëve të pranishëm tregon se ka kuorum të mjaftueshëm, do të thotë mund të fillojmë punën.

Sipas rendit të ditës, që e keni marrë me kohë, duhet t'ju informoj për një lëshim teknik në materialin që keni marrë në rend të ditës. Pika e parë që keni për rendin e ditës, në fakt është aprovuar në seancën e kaluar dhe në qoftë se ka ndryshime, mund të bisedojmë te pika e gjashtë e rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare. Unë besoj se mirëkuptim ka.

Zoti Dugolli kërkon fjalën. Urdhëroni, shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

### **BUJAR DUGOLLI:**

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar,

Më lejoni që në fillim të kësaj seance të jap një qëndrim të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës rreth punës së kësaj seance.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, konstaton se Projektrezoluta për njohjen e luftës shekullore të qytetarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi, me theks të veçantë luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila Projektrezolutë është dorëzuar tek shërbimet përkatëse të Kuvendit të Kosovës më 25 shkurt 2003, e ka mbështetjen juridike të bazuar në Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme, pika 9.1.26 nën a) dhe mbështetjen në Rregulloren e përkohshme të punës të Kuvendit Rregulla 9, si dhe mbështetjen morale dhe politike të shprehur në kërkesat e qytetarëve të Kosovës që lufta e UÇK-ës të njihet nga institucionet e Kosovës si luftë e drejtë çlirimtare dhe në favor të lirisë së popullit të Kosovës.

Pasi që Kosova nuk ka kushtetutën e vet, me anë të së cilës do të rregulloheshin dhe njiheshin meritat çlirimtare të Kosovës, Grupi ynë Parlamentar, dëshironte të japë kontribut që kjo çështje të hyjë në procedurë dhe të përkrahet për t'u hapë rruga procedurave të mëtejshme që statusi i dëshmorëve, invalidëve dhe i-familjeve të tyre që kanë marrë pjesë në luftën çlirimtare, të rregullohej me ligj.

Pra, Kuvendi i Kosovës duhet ta njohë luftën e UÇK-ës si luftë të drejtë dhe çlirimtare.

Grupi Parlamentar i AAK-ës është që kjo çështje të rregullohet me ligj të Kosovës dhe paraprakisht duhet të ketë një bazë apo pajtim të grupeve politike në Kuvend rreth vlerave të luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Rreth nismës së Grupit Parlamentar të AAK-ës, e cila nuk është vetëm kërkesë e deputetëve të AAK-ës, por është kërkesë edhe e deputetëve të partive tjera, konsiderojmë se janë bërë shkelje të rënda të rregullit demokratik të punës së Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit dhe vetë kryetari Daci, kanë shkelur Rregulloren e punës të Kuvendit, të miratuar nga ky Kuvend disa muaj më parë. Sipas Rregullës 8, ku flitet për detyrat e Kryesisë së Kuvendit, pika 4 dhe thuhet: "Kryesia siguron se çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga 6 ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës për seancën plenare të Kuvendit brenda 3 javësh pune prej kur është marrë shkalla e mbështetjes", mbyllim citatin. Por, fatmirësisht, këtë shkelje të procedurës nuk e kanë bërë të gjithë anëtarët e Kryesisë. Katër anëtarë të Kryesisë kanë qenë pro rrespektimit të procedurës ligjore, ndërsa katër, duke përfshirë votën e dyfishtë të kryetarit të Kuvendit, kanë shkelur rregullën e punës së Kuvendit. Po ashtu është shkelur Rregulla 9 e Rregullores së punës të Kuvendit ku flitet për të drejtat dhe detyrat e deputetit të Kuvendit, si dhe Rregulla 19, ku flitet për përcaktimin e rendit të ditës përkatësisht në pikën 3 dhe 4.

Duke marrë për bazë të gjitha këto parregullsi, shtrohet pyetja se sa do të jenë të rrespektueshme edhe ligjet që i sjell ky Kuvend në rast se Kuvendi gjegjësisht Kryesia dhe kryetari i Kuvendit bëjnë shkelje të rregullave të punës të Kuvendit dhe me këso veprimesh a janë duke u dëmtuar raportet e brendshme politike, imazhi i Kosovës dhe institucioneve të saj.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në shenjë pakënaqësie për këto veprime antiligjore, që u thanë më lartë, nuk do të marrë pjesë në këtë seancë plenare.

Grupi Parlamentar i AAK-ës nuk do të ndalet në kërkesën e vet që kjo çështje të rregullohet sa më shpejt, ashtu siç është kërkuar me Rezolutë, dhe posaçërisht në pikën 5 të Projektrezolutës së propozuar që Qeveria e Kosovës të përgatisë sa më shpejt ligjin për shpalljen e luftës së UÇK-ës si luftë e drejtë dhe luftë çlirimtare.

Ne përshëndesim nismën e Qeverisë dhe gatishmërinë e kryeministrit Rexhepi që në një periudhë sa më të shpejtë t'i sjell Kuvendit projektligjin e kërkuar.

Grupi ynë Parlamentar do të paraqesë mocion procedural konform Rregullës 26, pika 8, për shkeljen e të drejtave të deputetit dhe shkeljen e Rregullores së punës të Kuvendit nga një pjesë e anëtarëve të Kryesisë.

Ju falemnderit për vëmendje.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Berat Luzha, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

### **BERAT LUZHA:**

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk do të marrë pjesë në punimet e mbledhjes së sotme të Kuvendit në shenjë revolte dhe proteste ndaj Kryesisë, e cila, për të satën herë nuk e sheh të udhës që, duke shkelur edhe Rregulloren e punës të Kuvendit, ta fusë në rendin e ditës Projektrezolutën për njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të luftës sonë çlirimtare. Madje, kjo Kryesi, në mënyrë arbitrare, i ka ndaluar edhe shumë nisma të tjera të deputetëve dhe grupeve parlamentare.

Kjo praktikë, mendojmë, duhet ndaluar në mënyrë që Kuvendi të mund të zhvillojë punimet lirshëm, pa diktat, mbi bazë të normativave ekzistuese.

Ne mendojmë se Projektrezoluta nuk është vetëm e një grupi parlamentar. Ajo është e të gjithë neve që synojmë pavarësinë e Kosovës. Ajo është e një rëndësie të dorës së parë, jo vetëm politike. Kurse, nxjerrja e një ligji, nuk e përjashton në asnjë mënyrë nxjerrjen e saj. Rezoluta, përkundrazi, duhet të jetë bazë juridike për nxjerrjen e ligjit, edhe pse ligji duhet të ketë një rol krejt tjetër nga rezoluta.

Ne deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, mendojmë se Kryesia duhet të reflektojë në kërkesa të deputetëve dhe jo vetëm të tyre.

Kuvendi sot duhej ta kishte në rend dite edhe nxjerrjen e një deklaratë në mbështetje të intervenimit ushtarak anglo-amerikan në Irak me qëllim të heqjes nga skena politike të diktatorit të fundit, aleatit të kriminelit Millosheviq Sadam Huseinit.

Të nderuar deputetë,

Jemi shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e pazëvendësueshme të institucioneve tona, sidomos të Kuvendit, andaj atë duhet ta bëjmë vërtetë ashtu siç dëshirojmë, siç e dëshiron populli i Kosovës. Për një Kuvend, që nuk njih veten, që nuk njih sakrificat e popullit të vetë, gjakun e derdhur për liri të përjetshme, dëshmorët e kombit – Kosova vërtetë nuk ka nevojë.

Ne nuk kërkojmë të pamundshmen. Ne kërkojmë që ta bëjmë atë që e kemi për detyrë ta bëjmë, që na takon ta bëjmë, që kemi të drejtë ta bëjmë. Ne kërkojmë që në mbledhjen vijuese të shqyrtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës vetë funksionimi i këtij Kuvendi.

Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Hasan Meta.

#### **HASAN META:**

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Unë desha me pak fjalë, në një mënyrë, ta shpreh pakënaqësinë time për punën e Kryesisë së Kuvendit.

Mendoj se ekziston një defekt i madh në punën e Kryesisë së Kuvendit. Është e drejtë e qytetarëve të Kosovës, e drejtë jona këtu që jemi, që disa çështje të cilat janë fundamentale, të dalin në mënyrë të rregullt, në mënyrë rezolutash që janë propozuar. Nuk është me rëndësi kush e ka propozuar ndonjë rezolutë, por është me rëndësi çka përmban ajo rezolutë dhe që rezoluta është e nevojshme për punën e mëtutjeshme dhe për shumë çështje që janë fundamentale. Ky defekt i Kryesisë, nëse pak a shumë e studiojmë, del nga ajo mosvigjilenca jonë e përparshme në zgjedhjet qendrore, ku kemi lejuar, ku është imponuar përfaqësimi i minoriteteve në mënyrë joadekuate. Do të thotë, trefishimi i përfaqësimit të ndonjë minoriteti këtu dhe, për fat të keq, nuk janë shikuar pasojat që do vinin pastaj. Ne sot, me punën e Kryesisë që bëhet, e që nuk jemi të kënaqur dhe me ngecjen e punës së Kuvendit për shkaqe që Kryesia nuk kryen punën si duhet, kemi një mënyrë që peshoja shkon kah defekti i përparshëm që kemi lejuar.

Mendoj se duhet ta kemi të qartë, e po ashtu mendoj se qytetarët e Kosovës e kanë patur të qartë, por si duket subjektet politike jo sa duhet – që përfaqësimi i trefishaur i minoriteteve peshoren e çon nga interesi i tyre dhe nuk janë interes të minoritetit por interes të një vendi fqinj.

Duhet të kemi kujdes në të ardhmen për arsye të punës së mirë të Kuvendit që ky Kuvend ka shumë punë, ka shumë për të aprovuar ligje dhe nëse dojmë të ecim përpara, kjo duhet të kihet parasysh.

Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Nëse më lejohet, kam një sqarim të vogël.

Dy grupet parlamentare kanë një mundësi në bazë të Rregullores, që të ushtrojnë mocionin përmbajtësor, sipas Rregullës 26.8 të Rregullores Komisionit legjislativ dhe duke dashur që vërtet të vazhdojmë me frymën e punës njëvjeçare dhe frymë demokratike në këtë Parlament t'i falënderoj shefin e Grupit Palramentar dhe ushtruesin e detyrës së Grupit Parlamentar të PDK-ës dhe ta përkujtoj ushtruesin e detyrës së Grupit Parlamentar të PDK-ës për atë që kërkon shqyrtimin e punës së mëtutjeshme të Kryesisë. Mirë është të përkujtohen një vjet e sa ditë më parë. Ekziston një rregull në komunikacion. Me shpejtësinë, me të cilën ngjitesh përpjetë - vetëm me atë shpejtësi guxon të lëshohesh teposhtë.

Prandaj, në seancën plenare janë të pranishëm 72 deputetë dhe i falënderoj për pjesëmarrje, por do të doja tani të ekzistojë një mirëkuptim tjetër nga deputetët e pranishëm, nga tri grupet parlamentare të pranishëm si shumicë në Parlament: Për hirë të ruajtjes së stabilitetit të institucioneve, më lejoni ta falënderoj përzemërisht kryeministrin dhe ministrat që janë të gatshëm t'i kryejnë detyrat e veta dhe që janë sot të pranishëm me ne, dhe se vetë prania e tyre fizike tregon gatishmërinë profesionale dhe politike të tyre se janë në ballë të rrjedhave në Qeverinë e Kosovës.

Megjithatë, vlerësim imi është, por edhe nëse gabo, lus që të kuptoni se për hirë të hapave të fundit që po bëjmë për ruajtjen e një uniteti veprues në institucione - të mos kërkojmë sot të zhvillohet debati për ekspozenë ose për raportin e kryeministrit të paraqitur javën e kaluar. Ata iu kanë përgjigjur obligimeve të veta, janë të pranishëm. Prandaj, mendoj se duhet të kemi mirëkuptimin tuaj dhe këtë debat ta zhvillojmë bashkërisht atëherë kur jemi këtu me të gjitha grupet parlamentare.

Ju lutem, mund të deklarohe mi me votë formale për këtë. Unë po ju lus që të mos ngriten temperaturat individuale, emocionet individuale dhe kësaj radhe të mos jenë më të rëndësishme se ato tjerat.



Prandaj, vazhdojmë seancën plenare me pikat tjera të rendit të ditës dhe le të aprovohet kjo që po kërkohet sot dhe ta lirojmë kryeministrin e Qeverisë që t'i kryejnë punët e tyre dhe unë po shoh se për këtë kemi aprovimin absolut të shumicës. Ju falemnderit.

Kryeministër, së pari mirë se keni ardhur. Punë të mbarë ju dëshirojmë në detyrat që keni para veti, kurse lidhur me këtë do të bisedojmë një rast tjetër. Qeveria është e lirë, ju lutem.

S'ka problem, Saviq, fjalë do të merr secili. Urdhëroni, ose shefi i grupit parlamentar ose ju Saviq, cili të doni mund ta merrni fjalën. Urdhëroni Dragisha.

### **DRAGIŠA KRSTOVIĆ:**

Gospodine predsedniče, gospodo ministri, dame i gospodo poslanici,

Ja sam za ovom skupštinskom govornicom 6. marta ove godine, povodom predloga gospodina Dugolija i nekih drugih poslanika da se u dnevni red zasedanja uvrsti tačka o vekovnoj borbi gradjana Kosova za oslobodjenje, rekao to što sam rekao i danas sam samo još nešto više uvereniji da sam to što sam rekao, za to imao puno pravo.

Ja se danas neću vraćati na ono što sam tom prilikom izrekao, ali ću reći samo ovo: Jaz izmedju dva naroda na Kosovo i metohiji je danas dublji nego što je bio 6. marta. Imam utisak i uverenje da će taj jaz narednog četvrtka ili nekog sledećeg četvrtka biti još dublji. Ja vas pozivam da se založimo za nešto drugo, da te jazeve izmedju naroda na Kosovu činimo pričim i da ih premošćujemo nekim mostovima. Hvala lepo!

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Edhe anëtarë i Kryesisë, zoti Saviq, dhe nuk ka më të paraqitur për debat!  
Ju lutem, nuk kam hapur debat.

### **GOJKO SAVIĆ:**

Poštovani predsedniče, drage kolege,

Ja zaista, u ovom trenutku sada ne obračam se možda više vama nego obračam se monitoringu koji ovo prati. Mi smo imali već nekoliko puta prilike da slušamo o pokušaju da se rezolucija koja je već pomenuta uvrsti u dnevni red. To je bilo i na ranijim sednicama Predsedništva, gde smo mi bili jednoglasni i odbacili. A onda se to pojavilo na Skupštini, Skupština je to jednoglasno odnosno sa većim brojem glasova odbacila. I pored toga, imali smo razumevanje u Predsedništvu, pre dva dana i na insistiranje predstavnika iz Alijanse za budućnost dozvolili smo još jednom da Predsedništvo glasa,

što je neuobičajeno i nenormalno, po meni i, i na tom Predsedništvu to nije moglo da prodje. I pored toga, ja opet, opet razumem da danas par ljudi izadje i kaže da bi želeli da to uvrste i tako dalje, ali bez promocije. Dakle, to bi trebalo prekidati jer se govori o tačkama dnevnog reda.

Zatim, ova druga greška, koja je zaista jako gruba greška, učinjena od strane predsednika, u ovom trenutku je skidanje sa dnevnog reda raspravu o ekspozeu predsednika Vlade. Pa to, bez glasanja, bez mogućnosti da se bilo šta kaže, jednostavno se to skida sa dnevnog reda, i ja molim one koji su zaista zaduženi za to da vode računa o svemu ovome. To znači, mi možemo ovde da dopisujemo, da skidamo onako kako hoćemo. Jednostavno ja sam, iako nisam bio prisustvovao zbog opravdanih razloga prilikom izlaganja, ali sam ja lepo pročitao taj ekspozu, pripremio se i ja želim da kažem ono što mislim i nema nikakvog razloga, jer uvrštavanje ove tačke odnosno pokušaj uvrštavanja još jedne tačke dnevnog reda, nema nikakve veze za skidanje sa dnevnog reda tačke – Rasprava o ekspozeu. I ja ponovo upozoravam, kažem međunarodnoj zajednici koja prati, jer govori se o Skupštinskom radu da to ode na ono mesto gde inače treba da se zna da mi zaista nemamo tu nikakvih mogućnosti onda da utičemo na već utvrđeni dnevni red na Predsedništvu od pre dva dana. Hvala!

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Edhe Grupi Parlamentar, në emër të grupit zëdhënësi Sadik Idrizi.

### **SADIK IDRIZI:**

Mislim da je odlaganje rasprave, već po drugi put, dobija na tome da će ova rasprava izgubiti od svog osnovnog značenja odnosno smisla. U trenutku kada je ekspozu podnet ovde bili smo spremni, znači, svi poslanici da damo doprinos, da ukažemo na rad Vlade u protekloj godini i da damo smernice za dalji rad. Dvostruko odlaganje odnosno način na koji je to opet uradjeno učiniće da možda nikada neće doći na red rasprava po izveštaju o radu Vlade.

Još jedna, veoma bitna stvar, koja se danas ovde čula od poslanika Mete. Mislim da je to jedna uvreda za druge zajednice. Mi smo ta kategorija drugih zajednica, i verovatno su i neki drugi našli mesta sebi tamo. U Ustavnom okviru je određen taj broj poslanika odnosno dodatnih mesta. To su prihvatili i politički subjekti, to je potvrđeno Ustavnim okvirom i taj broj je važeći i on je takav kakav jeste. Oni koji su to odredili imali su na umu više stvari. Prije svega mislili su na dobar deo raseljenih pripadnika ovih drugih zajednica, koji nakon rata na Kosovu nisu više tu i sa čijim brojkama ne može tačno odnosno čija brojka nije mogla tačno da bude utvrđena. Mislim da takve kvalifikacije odnosno takav pristup stvarima ne rešava problem koji imamo. Mi želimo da budemo konstruktivni deo. Ove druge zajednice žele da u ovom Parlamentu se rešavaju ključni problemi, esencijalni problemi sa kojima se suočavaju građani Kosova.

Kao Parlament, moramo napraviti dogovore, još dodatne dogovore izmedju poslaničkih grupa, izmedju šefova poslaničkih grupa, izmedju partijskih lidera ako mislimo da ovaj mandat odradimo kako valja, da damo neki svoj doprinos. Inače, svakodnevnim ostavljanjem odredjenih stvari, i ja ne želim da prejudiciram da li je u redu neka deklaracija ili ne, koliko je njena vrednost ili značaj, da li je to dobro ili nije, ali mislim da ovaj Parlament se prečesto i previše bavi problemima zastoja a ne problemima koji bi vukli napred. Hvala.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Të vazhdojmë. Pikë e rendit të ditës është – Miratimi i procesverbalit.

Unë besoj se vërejtje nuk kemi, por në qoftë se ka, jemi marrë vesh që me shkrim t'i paraqesin.

Ju lutem zoti Meta, ka shumë kërkesa për t'ua dhënë fjalën, ka edhe të koalicionit "Kthimi", ka edhe të LDK-ës, e tjera.

E dij që në rrethana të vështira është shumë vështirë të kënaqen 120 deputetë, por përgjegjësitë politike dikush duhet t'i bartë dhe duhet t'u prijë proceseve të zhvillimit...

Ju lutem, pasi në procesverbal nuk ka vërejtje, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për farërat.

Amendamentet i kemi të gjithë para veti, prandaj të shkojmë radhazi.

**Amendamenti 1.** Komisioni funisional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për këtë amendament, le të çojë dorën.

Ju falemnderit.

A ka kush kundër këtij amendamenti? Nuk ka asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim. Ju falemnderit.

**Amendamenti 2.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim. Ju falemnderit.

**Amendamenti 3.** Komisioni funksional, pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Urdhëroni, Tomë.

### **TOMË HAJDARI:**

Zoti kryetar, këtu kemi vetëm për çështje nomenklature. Këtu nuk ka kurgjë esenciale. Është çështja për kategorinë e patateve për farë, gjegjësisht farës së patateve. Ju lutem, kemi konsultuar edhe biologët edhe Akademinë e Shkencave të Arteve, për fat të mirë edhe në Komisionin tonë kemi njerëz të profesionit m'u të kësaj lëmie dhe kemi debatuar që në bazë të kategorisë dhe familjes që bjen patatja duhet patatja për farë.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju lutem, kush është për Komisionin profesional? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim. Ju falemnderit.

**Amendamenti 4.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim. Ju falemnderit.

**Amendamenti 5.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Ju falemnderit.

**Amendamenti 6.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete dhe Komisioni për legjislacion, por pa komisionin funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 7.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

Urdhëroni, doni sqarim.

### **TOMË HAJDARAJ:**

Unë mendoj se qëndron ajo që ka punuar Komisioni parlamentar, domethënë funksional, sepse kemi të bëjmë me direktivën administrative. Ju lutem, akte ligjore, rregulla mund t'i quajmë ato, janë edhe rregulloret. Unë nuk di si mund ta miratojmë ne – direktivë administrative. Ne kemi luftuar kundër direktivave, e tash po i pranojmë prap direktivat. Nuk di ku është arsyeshmëria aty dhe pse. «Direktivë administrative» në ligj s'di sa është e qëndrueshme. Ne qëndrojmë pranë asaj. Ju votoni.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Kush është për Komisionin për buxhet dhe Komisionin për komunitete? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim. Ju falemnderit.

Për çka dëshironi të diskutoni? Ke të drejtë për amendamente të diskutosh e jo për Rregullore të punës. Urdhëro!

**MILENA KENIĆ:**

Poštovani predsedniče,

Ja se izvinjavam, ali moram da prekinem ovo glasanje jer stvarno nije u skladu sa Poslovníkom. Mislim da se ovo i ranije dešavalo a i sada da se glasa za amandmane za «za» ili «protiv» bez tačnog utvrđivanja broja glasova. Ja stvarno ne znam, nije ovo u redu. Kažete «većina glasova». Mislim to je stvarno smešno. Meni bar... Stvarno nije u redu. Hvala.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Deputetja ka të drejtë në qoftë se mendon se nuk po i numërojmë. Jemi shumë mbrapa. Numërohen gjithmonë, por në qoftë se optikisht shihet se krejt votojne per, dhe unë pyes a ka kush kundër – nuk ka asnjë votë kundër. Pyes – kush abstenon, nuk abstenon askush. Unë s’e di qysht t’i numërojmë ndryshe. Prandaj, nuk ka thyerje të Rregullores, janë 72 deputetë të pranishëm dhe votojnë të gjithë.

**Amendamenti 9.**

Komisioni funksional, pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Le të urdhërojnë ata që s’e përkrahin e të shpjegohet.

**HAKI SHATRI:**

Ju falemnderit, zoti kryetar,

Komisini për buxhet është i vetëdijshëm se kjo që është propozuar këtu, në fakt kjo që nuk është përkrahur nga Komisioni për buxhet nuk ka të bëjë me implikimet në buxhet. Por njerëzit që kanë marrë pjesë si ekspertë nga ministria përkatëse na kanë sygjerruar që ta zëvendësojmë fjalën “linjë” me “vijë”, sepse është konsideruar që është më shqip. Në qoftë se vlerësohet se e kemi pasë gabim, ne nuk ngulim këmbë sepse nuk është në resorin tonë. Ju falemnderit.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Unë mendoj se duhet të përkrahet Komisioni funksional dhe lekturën gjuhësore tjetër kush ta bëjë.

Prandaj, kush është për Komisionin funksional? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush? Katër abstenojnë. Ju falemnderit.

Po ju kërkohet falje sepse amendamentin 8 e kemi kaluar. Rrethanat janë të atilla, prandaj më lejoni që të kthehem në amendamentin 8, pas tërheqjes së vërejtjes.

**Amendamenti 8.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Asnjë votë kundër. Me qëllim po them “asnjë votë kundër”, sepse nëse ndokush ka votuar kundër, le të protestojë.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 10.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 11.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 12.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenon. Ju falemnderit.

**Amendamenti 13.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga komisioni për komunitete.

Komisioni që kundërshton – Komisioni funksional a është kundër? Përkrahet.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 14.** Komisioni funksional, pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Ata që janë pa përkrahje, le të arsyetoj në pse s'e përkrahin.

**(Flet nga vendi, nuk dëgjoet sa duhet: Vetëm një informatë të shkurtër. Ne jemi pajtua me këtë që ka pru Komisioni por si duket... nuk ka përmirësua këtë)**

Kush është për tekstin e unifikuar të komisioneve? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Një abstenon. Ju falemnderit.

**Amendamenti 15.** Komisioni funksional, pa përkrahje nga komisionet kryesore.

Tomë, është bërë harmonizimi?

Me harmonizim, kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Dy abstenime. Ju falemnderit.

**Amendamenti 16.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.



Funksionali qenka kundër, apo ka sqarime? Ajo “direktiva” si më parë! U krye kjo, atëherë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Tre abstenime.

**Amendamenti 17.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 18.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 19.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 20.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një votë kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim. Ju falemnderit.

**Amendamenti 21.**

Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 22.**

Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 23.**

Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 24.**

Komisioni funksional, pa përkrahje nga komisionet kryesore.

**(Flitet prej vendit: Qëndrojmë pranë asaj, dhe në gjuhën shqipe “patate për fara”...)**

Domethënë, të njëjtat përmirësime. Kush është për, me këto propozime? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një votë kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

**Amendamenti 25.** Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

E përkrahni edhe ju. Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

**Amendamenti 26.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 27.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 28.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 29.** Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 30.**

Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

**Amendamenti 31.**

Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

**Amendamenti 32.**

Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete dhe nga funksionali.

Kush është për? Ju falemnderit.

A kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

**Amendamenti 33.**

Komisioni për buxhet, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

Urdhëroni.

**SABIT RRUSTEMI:**

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,

Unë propozoj që amendamenti 33 në nenin 28, të duket kështu: “Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe nënshkrimi i kryetarit të Kuvendit të Kosovës”. Pjesa tjetër të fëshihet. Ju falemnderit.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju lutem, kush është për amendamentin e paraqitur ashtu si është harmonizuar? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Tre kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Tani kemi për detyrë që të deklarohe mi për Ligjin në tërësi.

Kush është për, i lutem le të çojë dorën.

Urdhëroni, shefi i Gupit parlamentar koalicionit "Kthimi" e ka fjalën.

**DRAGIŠA KRSTOVIĆ:**

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Ja sam jednom prilikom, kad je Skupštinom predsedavao jedan od članova Predsedništva, u kazao na odredbu člana 33. stav 3. Privremenog poslovnika Skupštine Kosova, koja glasi: «U slučajevima kada se svi amandmani, koji su uzeti na razmatranje, usvojeni ili odbačeni, o tekstu nacрта zakona sa izvršenim izmena ma vrši se konačno glasanje». Ja ovu odredbu tumačim tako što mislim da zakon treba... Sve izmene, sve amandmane koji su danas usvojeni treba ubaciti u Zakon i napraviti jedan integralni tekst Zakona koji će se kao takav usvajati na narednoj sednici Skupštine. To je moje tumačenje, mislim tu je Sekretarijat, tu je ...

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zoti Kërstoviq. Ne kemi konsultuar gjithmonë të gjithë këshilltarët e mundshëm kombëtarë e ndërkombëtarë. Mendimi juaj duhet të rrespektohet, megjithatë ne po vazhdojmë me atë që ka qenë praktikë e rekomanduar nga të gjithë këshilldhënësit e paguar për këtë punë.

Kush është për Ligjin për farërat në tërësi, ju lutem.

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Nuk abstenon askush.

**Prandaj, konstatoj se njëzërit u aprovua Ligji për farërat, në tërësi.**

<b><u>Votimi – Glasanje – Voted:</u></b>	
<b>Për - Za - For:</b> .....	<b>72</b>
<b>Kundër – Protiv – Against</b> .....	<b>00</b>
<b>Abstenuan – Uzdržanih – Abstained</b> .....	<b>00</b>

( Duartrokitje)

Pika tjetër është: **Shqyrtimi i propozimit për miratimin e Inisiativës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional.**

Ministri përkatës, që ka përgatitur këtë, nuk është prezent në seancë, prandaj nuk mund të shqyrtohet kjo çështje dhe hiqet nga rendi i ditës.

Nën pikën e gjashtë të rendit të ditës: Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare për 27 mars 2003, do të thotë sot një javë, kemi si vijon:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluejtshme në Kosovë, dhe**
- **Shqyrtimi i Raporit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës.**

Asnjë grup parlamentar nuk ka paraqitur ndonjë propozim apo ankesë dhe konsideroj se pranohet ky rend dite.

Për pikën e fundit të seancës së sotme, ju informoj se nuk ka patur pyetje konform rregulloreve në fuqi.

Mirëupafshim në seancën e ardhshme. Ju falënderoj për pjesëmarrje.

**Seanca përfundoi në orën 11,20.**

Rt/1-20